




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK
Nr. i treg. Ishurj shifrimit Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	03-02/2632/18
Deja Datum Data	29-08-2018
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.08.2018, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-1702/18, për zyrtarin e lartë z. Mustafë Nila, Drejtor i Gjeodezisë dhe Kadastrit në Komunën e Pejës, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë z. Mustafë Nila, Drejtor i Gjeodezisë dhe Kadastrit në Komunën e Pejës dhe njëkohësisht Kryetar i Klubit Futbollistik "Besa" - Pejë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia kundër Korrupsionit, fillimisht e ka njoftuar zyrtarin e lartë me një shkresë zyrtare për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese zyrtari i lartë është njoftuar për situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.



Gjatë procedurës së zhvilluar për konflikt interesi, Agjencia i ka dërguar shkresë paralajmëruese zyrtarit të lartë, me të cilën është konstatuar se ushtrimi i funksionit Drejtor i Gjeodezisë dhe Kadastrit në Komunën e Pejës dhe njëkohësisht Kryetar i Klubit Futbollistik “Besa” – Pejë është i ndaluar me nenin 14 (paragrafi 1) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, në të cilën thuhet:

“Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të tjera të lidhura me to”.

Pas kësaj, zyrtari i lartë z. Mustafë Nila është deklaruar se tashmë nuk e ushtron funksionin Kryetar i Klubit Futbollistik “Besa” – Pejë sepse është shkarkuar nga kjo detyrë nga Kuvendi i Klubit Futbollistik “Besa” – Pejë.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar edhe shkresën zyrtare (DPKI.03-02/2407/18) me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë z. Mustafë Nila nuk e ushtron funksionin Kryetar i Klubit Futbollistik “Besa” në Pejë sepse është shkarkuar nga kjo detyrë nga Kuvendi i Klubit Futbollistik “Besa” – Pejë. Me këtë rast është evituar gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

